



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2022:280916
Datë: 18.03.2024
Numri i dokumentit: 05463445

C.nr.1969/22

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Durim BALAJ, në çështjen juridike të paditësit K.B., nga fshati Komuna e Gjakovës, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat Arben Biblekaj nga Prishtina, kundër të paditurit A.SH., nga fshati ... Komuna e Pejës, me objekt kontesti: borxh, jashtë shqyrtimit, me 18 mars 2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET marrëveshja jashtëgjyqësore Nd.nr.23/24, e datës 07.03.2024 lidhur në Zyrën për Ndërmjetësim në Gjykatën Themelore në Gjakovë, në mes të paditësit K.B., nga Gjakova, kundër të paditurit A.SH., nga Peja, në çështjen juridike: për borxh, dhe e njëjta e ka fuqinë e titullit përmbarues.

II. Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është marrëveshja e ndërmjetësimit Ndr.nr.23/24, e datës 07.03.2024

A r s y e t i m

Gjykata, përmes njoftimit të datës 01.02.2024 i ka ftuar palët ndërgjyqëse që çështjen kontestimore ta zgjidhin në procedurën e ndërmjetësimit, dhe pas shprehjes së vullnetit nga palët, me vendimin numër C.nr.1969/22 të datës 21.12.2022, e ka referuar lëndën në Qendrën për ndërmjetësim në Gjykatën Themelore Gjakovë për veprim të mëtejme, e cila është regjistruar me numrin e referencës së ndërmjetësimit Ndr.nr.23/24.

Qendra për ndërmjetësim në Gjykatën Themelore Gjakovë, me datë 07.03.2024 në rastin konkret e ka njoftuar gjykatën se palët kanë me arritur që kontestin lëndor të e zgjidhin me marrëveshje

jashtëgjyqësore në Qendrën e Ndërmjetësimit ashtu që gjykatës ia ka dorëzuar ekzemplarën e marrëveshjes për zgjidhjen e kësaj çështje sipas procedurës së ndërmjetësimit.

Gjykata me rastin e shqyrtimit të marrëveshjes së palëve në procedurë të arritur me ndërmjetësim, ka konstatuar se e njëjta nuk është lidhur në kundërshtim me Ligjin dhe për këtë arsye bazuar edhe në dispozitat ligjore të nenit 3 par. 3.3, nenit 411 par.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, lidhur me nenin 4, 5, 11, 12, 14, 15 par.1 dhe nenit 17 të Ligjit për Ndërmjetësimin me nr.06/L-009, erdhi në përfundim se marrëveshja jashtëgjyqësore duhet të aprovohet dhe si e tillë e njëjta e ka fuqinë e titullit përmbarues.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.1969/22, me 18 mars 2023

G J Y Q T A R

Durim BALAJ

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.